

329:342.849.2:321.7-027.18

Muhamed Jashari, Ma<sup>1</sup>

Xhenur Iseni, Ma<sup>2</sup>

## DIKOTOMIA “E DJATHTË” DHE “E MAJTË” NË DISKURSION E PARTIVE POLITIKE

## ДИКОХОТОМИА “ДЕСНИЧАР” И “ЛЕВИЧАР” ВО ДИСКУРСОТ НА ПОЛИТИЧКИТЕ ПАРТИИ

## THE DICOTHOMY OF “RIGHT” AND “THE LEFT” IN THE POLITICAL PARTIES' DISCOURSE

### Abstract

There is no doubt that the political will of the electorate is carried out through free elections. But, the political platform that is served to the society by a group of organized people is made only through political parties. Therefore it's impossible to write or talk for a sustainable democracy without mentioning political parties. They are simply “*an inseparable part of the democracy*” (Russell Dalton), or as Max Weber calls them “*the children of the democracy*”.

The rules of the pluralism and the parliamentary life in the country are built through the political battles of the parties. The parties enable the citizens to compete for political functions, by doing this, they are considered as the only instrument that enables the changing of the state's structures.

Political parties are still an object of research of many social sciences like, politicalology, sociology, the sociology of political parties, etc. The fact that there are so many publications in this field makes us believe that the political parties are still in a great interest for the researchers.

In the following article initially we will treat the history of the political parties, their definition and their relation with the state. The subject of this

---

<sup>1</sup> MA, in Political Science, International Relations and Diplomacy. (researcher of International relations). [muhammed\\_j88@hotmail.com](mailto:muhammed_j88@hotmail.com)

<sup>2</sup> MA, in Political Science, International Relations and Diplomacy, Journalist in “ZHURNAL” Newspaper, Republic of Macedonia. [xh.iseni@gmail.com](mailto:xh.iseni@gmail.com)

study will also be the division in “Left political parties” and “Right political parties” and their role in the society. It’s worth mentioning that in this work we have used the interview as a scientist methodology.

**Key Word:** Political Parties, Election, Typology of Parties, Democracy, Political Races, Contemporary Democracy.

### Abstrakt

Pa dyshim se vullneti politik i trupit votues apo i elektoratit, shprehet përmes zgjedhjeve të lira. Mirëpo, platforma politike që një grup individësh, të organizuar, ia ofrojnë shoqërisë bëhet vetëm nëpërmjet partive politike. Andaj, është e pamundur që të shkruash ose të flasësh për një demokraci të qëndrueshme, e të mos përmenden partitë politike. Thjeshtë, partitë politike janë *“pjesë e domosdoshme e demokracisë”* (Russel Dalton), ose ashtu siç i quan Veberi (Max Weber) *“fëmijët e demokracisë”*.

Përmes betejave politike të partive, ndërtohen rregullat e pluralizmit dhe të jetës parlamentare në një vend. Partitë politike u mundësojnë qytetarëve që të jenë në gara për funksione politike, kështu konsiderohen i vetmi instrument që e ndihmon ndryshimin e strukturave shtetërore.

Çështja e partive politike edhe më tej mbetet objekt studimi i lëmive të ndryshme të shkencave sociale dhe atë, qoftë politologjisë, sociologjisë, sociologjisë së partive politike, etj. Për vet faktin se në këtë drejtim, ka publikime të shumta, jep të kuptojmë se hulumtimi i partive politike edhe më tej zgjon kureshtjen e studiuesve.

Në artikullin e mëposhtëm do të trajtohet fillimisht historiku i partive politike, përkufizimi i tyre, relacionet e partisë me shtetin. Objekt studimi po ashtu do të jenë ndarjet *“parti majtiste”* ose *“parti djathtiste”*, dhe çfarë roli luajnë ato sot në shoqëri. Vlen të përmendin se në këtë punim kemi përdorë edhe intervistën si mjet i metodologjisë shkencore.

**Key Word:** Political Parties, Election, Typology of Parties, Democracy, Political Races, Contemporary Democracy.

### Mbi gjenezën e partive politike

Tek studiuesit e kësaj fushe vazhdimisht kureshtje ka zgjuar çështja e zanafillës apo gjenezës së partive politike, mënyrën se si dhe në çfarë rrethana historike lindën. Por, ajo që duhet të thuhet që në fillim është fakti se jo të gjithë mendimtarët janë unik në mendimet e tyre në lidhje me paraqitjen e partive politike.

Disa prej tyre mendojnë se partitë politike lindën në shekullin e XIX, por ka edhe të atillë që pohojnë se paraqitja e partive politike është shumë më herët, këta pohojnë se partitë janë paraqitur me ndarjen e shoqërisë në klasa. (Aziri, 2004:13).

Ndërsa studiues tjerë janë të mendimit se organizimet e tilla i hasim që në Athinën e lashtë, përkatësisht atëherë kur grupime të ndryshme janë munduar që në mënyrë aktive të ndikojnë në debatet dhe vendimet e asamblesë popullore. (Diamond & Gunther, 2001:40).

Mirëpo, vlen të thuhet se këto formacione ose organizime kishin të përbashkët faktin se formësoheshin përreth faktorësh rrethanorë. Ato vinin në shprehje si pasojë e ndonjë personaliteti karizmatik, apo si rrjedhojë e ndonjë situatë krize që kërkonte domosdoshmërisht një mbrojtje të përshtatshme. Çdo ndryshim i rrethanave, vdekje e drejtuesit, zgjidhja e krizës e kështu me radhë çonte në shpërndarjen e lëvizjes. (Denquin: 83).

Studiues të ndryshëm mbajnë qëndrimin se partitë politike për herë të parë janë paraqitur në kohën e Republikës Romake, dhe se romakët janë ata të cilët e zhvilluan idenë moderne të partive.

I pamohueshëm është fakti se partitë e para politike u formuan në SHBA në fund të shek. XVIII. Më vonë, gjegjësisht gjatë shek XIX partitë politike me kuptim të plotë të fjalës u paraqitën në Britani të Madhe, Francë ndërsa më pas edhe në disa vende tjera të Evropës, si në Gjermani, Itali, Belgjikë, Suedi etj. Më tej në fund të shek. XIX partitë politike u paraqiten edhe në kontinente tjera të botës, si p.sh. në Amerikën Latine, Azi ose Afrikë.

Për vet faktin se formimi i partive politike morri hov të madh në fund të shek. XVIII dhe gjatë gjithë shek. XIX jep të kuptojmë se formimi i tyre në kuptim të plotë të fjalës, në masë të madhe është i ndërlikuar me demokracinë qytetare. Kjo ngase në këtë periudhë u krijuan kushtet që mundësuan zhvillimin e mëtutjeshëm të demokracisë parlamentare. Që këtu mund të themi se partitë politike erdhën si rezultat:

1) Përhapjes së drejtës së përgjithshme të votës dhe

2) Dëshira e votuesve që në mënyrë të organizuar të ndikojnë tek anëtarët e parlamentit. (Климовски & Каракамишева, 2006: 68-69).

Teoricienët e kësaj fushe pohojnë se subjektet apo partitë politike kanë luajtur rol vendimtar në themelimin apo funksionimin e duhur të demokracisë. James Bryce - *akademik dhe politikan britanez* – thekson “partitë janë të pashmangshme, asnjë vend i lirë nuk ka qenë pa ato, si dhe askush nuk ka treguar se si përfaqësuesit e qeverisë mund që të veprojnë pa partitë politike. (Dalton, Farrell, McAllister, 2011:3).

Pa mos pasjen e organizimeve të tilla politike në një vend ose shoqëri, është e pamundur të flasësh për demokraci të zhvilluar.

Partitë politike janë krijesa të reja shoqërore, ato vijnë si rezultat i zhvillimeve demokratike të botës kapitaliste dukuri e të gjitha shoqërive bashkëkohore që synojnë demokracinë.

Kësisoj ato konsiderohen institucione dhe subjekte themelore të funksionimit të rendit demokratik, një kusht i pashmangshëm i lojës demokratike, i pluralizmit politik dhe i jetës parlamentare. (Pajaziti, 2009:477).

Mund të thuhet që institucionalizimi i partive politike në Evropën perëndimore por edhe në vende tjera u bë i mundur vetëm atëherë kur erdhi në shprehje demokracia parlamentare, madje jo vetëm kaq por, tanimë partitë politike luajnë rolin e ndërmjetësit mes qytetarëve dhe organeve kushtetuese në një shtet. Llogaritet se pas luftës së dytë botërore, gjegjësisht nga fundi i viteve të 50-ta, rreth 80% e shteteve të botës drejtoheshin nga partitë politike.

### **Koncepti *parti politike***

Nëse njeriut të rëndomtë ia përmendim fjalën “parti”, gjëja e parë që ai nënkupton me këtë shprehje është “diçka që ndahet”. Në lidhje me këtë studiuesi francez Pierre Avril pohon se ideja e partisë është sinonim i ndarjes, mirëpo urtësia që nga antikiteti e deri sot e kësaj dite na mësoi se, nuk ka gjë më të keqe për polisin (qytetin, shtetin) se sa ndarja.

Vlen të përmendet se jo të gjitha grupimet politike mund të llogariten si parti politike. Atëherë kur ekziston një pushteti i caktuar, ekziston dëshira për t’u marrë dhe për t’u ushtruar nga ana e ndonjë grupacioni politik apo partie politike.

Partitë politike përfaqësojnë organizatat që janë të orientuara drejt arritjes së kontrollit legjitim të qeverisë përmes procesit zgjedhor. Thënë shkurt partitë politike janë organizata që kanë për qëllim marrjen dhe ruajtjen pushtetin, paraprakisht duke iu futur garës zgjedhore. Vetëm në këtë mënyrë mund të përliqjet ekzistenca e një partie politike.

Në qoftë se e ndjekim logjikën e funksionimit të partive politike, do të konstatojmë se fitimi i votave nuk është asgjë tjetër përveç se rrugë legale për të arritur deri te pushteti shtetëror.

Fjala parti përbën një nga termat më të vjetër të leksikut që përdorin shkencat shoqërore. Në kuptimin etimologjik shprehja ose fjala parti rrjedh nga një kuptim i vjetëruar i foljes “partir” që në frëngjishten e vjetër kishte kuptimin të ndash, ose të veçosh. Ndërsa në latinisht shprehja “pars” nënkuptonte “pjesë”. (Daniel-Luius Seiler, 2000:12).

Në rast se një parti arrin që ti asgjëson apo ti eliminon kundërshtarët e saj politik ose krijon zbrazëti politike, tanimë ajo ndërron natyrë, në këtë mënyrë ata pushojnë së qenuri parti, pra pushojnë së luajturi rolin e tyre si parti politike. Filozof, sociolog, politolog e studiues të ndryshëm iu qasen përkufizimit të asaj që neve e kemi quajtur parti politike.

Kontribut të çmuar në lëmin e studimit të partive politike si dhe të shkencave politike në përgjithësi s'do mend ka dhënë sociologu i madh gjerman Maks Veber - (Max Weber).

Në veprën e tij voluminoze “Ekonomia dhe Shoqëria” (Wirtschaft und Gesellschaft), Veberi për partitë politike ndër tjerash pohon se: “Veprimtaria e partisë është e përkushtuar për të siguruar pushtetin për drejtuesit, si dhe për të realizuar një ideal ose për të përfituar avantazhe materiale për anëtarët aktivë të saj”. (Weber, 1978: 284).

Ky përkufizim i Veber-it i dhënë kohë më parë thajse është identik me mënyrën e funksionimit të partive politike sot, sidomos në truallin ballkanik.

Kur është në pyetje hulumtimi i fenomenit të partive politike doemos të përmendet sociologu dhe politikani francez Moris Diverzhe (Maurice Duverger), madje libri i tij mbi partitë politike konsiderohet bazë në dekadat e fundit. Ai kur flet për mënyrën e funksionimit të partisë pohon se partitë: “janë një bashkësi grupesh, të shpërndarë në të gjithë vendin, të lidhura midis tyre me institucione koordinuese”.

Politologët bashkëkohorë përkrahje në masë të madhe i kanë dhënë përkufizimit të Joseph LaPalombara-s dhe Myron Wiener-it . Sipas tyre që një grup të mund të konsiderohet parti politike ai duhet të i përmbush këto katër kritere.

- Vazhdimësia në organizim, një organizim i cili nuk do varet nga jetëgjatësia e drejtuesve të partisë;

- Organizim që duket i përhershëm në nivel lokal, të mos mungojë komunikimi i rregullt dhe mënyra të tjera marrëdhëniesh ndërmjet elementëve vendorë dhe kombëtar;

- Vendosmëri e drejtuesve për të marrë dhe ruajtur pushtetin vetëm ose në koalicion me të tjerët, si në nivel lokal ashtu edhe atë kombëtar;

- Të ketë një organizim të atillë i cili do të përpiqet të fitojë partizan ose përkrahës gjatë zgjedhjeve në mënyrë që të fitojë mbështetjen e popullit. (Daniel-Luius Seiler, vep. e cituar).

Marrë në përgjithësi partitë politike janë organizime individësh por që kanë një organizim juridik, veprimtaria e tyre kryesisht i dedikohet marrjes dhe rruajtjes së pushtetit si dhe realizimit të platformave politike që drejtuesit e partisë ia kanë ofruar elektoratit.

Nga kjo që u cek më lart mund të thuhet se partia politike përbehet nga këto elemente ose tipare:

- a) është formë organizimit politik të qytetarëve;
- b) ka një platformë ose program përmes së cilës mbështet veprimtaria e saj;
- c) vepron në një territor të caktuar, madje zhvillon garë politike qoftë në nivel lokal por edhe atë nacional; dhe
- d) lufton për fitimin e pushtetit me anë të zgjedhjeve të përgjithshme.

Pra, partitë politike krahas shtetit, konsiderohen subjekte që garojnë me shtetin në sfera të ndryshme të rrjedhojave shoqërore.

### **PARTIA *versus* SHTETI**

Krijimi i institucioneve shtetërore bën të mundur vazhdimësinë e shtetit edhe në rastin kur udhëheqësit shtetëror janë të vdeqshëm.

Institucionalizimi i partive politike mundëson që ato (lexo: parti-të politike) edhe pas humbjes në zgjedhje ose dorëheqjes së drejtuesve të partisë të vazhdojnë së ekzistuari, jetëgjatësia e partive politike ashtu sikurse e një shteti nuk është e kufizuar në afat kohor.

Partitë politike në shkallë të madhe ngjasojnë me shtetin kur është në pyetje organizimi i tyre dhe hierarkia që posedojnë. Madje, Diverzhe pohon se partitë anëtarësohen në organizata federative mu ashtu sikurse anëtarësohen shtetet në organizata ndërkombëtare.

Në shoqëritë bashkëkohore shteti është shndërruar në organizatë të gjithëfuqishme kurse partitë politike janë të vetmet organizata që e provojnë fuqinë me të, garojnë që ta marrin përparësinë në rrafshin politik dhe njëkohësisht t'i ndajnë në mes vete privilegjet e shumta. (Aziri: vep. e cituar).

Atëherë kur një parti politike arrin që të fitojë zgjedhjet dhe dominon skenën politike të një vendi, ritën tendencat që aparaturën shtetërore ta vendos në shërbim të saj. Në këtë mënyrë shteti shndërrohet në instrument të partisë që ka në duar frerët e pushtetit. Tanimë, kur partitë e tilla fitojnë pushtetin, ata bëhen parti sunduese ose parti regjimi në këtë formë duke i shtypë partitë rivale vendosin një marrëdhënie të përhershme me makinerinë shtetërore.

Partizimi i skajshëm i institucioneve shtetërore madje edhe i gjykatave – institucione të pavarura - ka mundur që partia, interesat e saja partiake ti shohë si interesa shtetërore, kështu që vullneti i partisë është bërë vullneti i shtetit. Kjo mënyrë e të vepruarit apo afërsi e skajshme mes partisë dhe shtetit ishte model i regjimeve komuniste, një partiake.

Një bashkëpunim i tillë mes partisë dhe shtetit kohëve të fundit na masë të madhe është vërejtur edhe në Republikën e Maqedonisë. Partia dominuese e bllokut politik maqedonas shndërroi shtetin dhe aparaturën shtetërore në shërbim të vetin, e si pasojë, interesat e saja ti shohë si interesa shtetërore të Maqedonisë.

### **E djathta dhe e majta në diskursin politik**

*“Fjalët e majtë dhe e djathtë nuk kanë asnjë domethënie”.*  
(Pierre de Pressac)

Fillimisht duhet përmendur se partitë politike mund që ti ndajmë në bazë të disa kriterëve dhe atë organizimit, qëllimeve politike, strukturës së brendshme etj. Mirëpo në këtë artikull do të ndalemi vetëm tek ato dallime të partive politike që mbështeten në orientimin ideologjik apo thënë më mirë tek partitë e etiketuara si “të djathta” ose “të majta”.

Teza e një ndarje të këtyllë ka origjinën e saj në traditën parlamentare franceze. Pas revolucionit të vitit 1789 në përbërjen parlamentare të republikës së parë franceze, deputet në parlament uleshin në gjysmë rreth dhe atë sipas bindej së tyre politike.

Në anën e djathtë të fronit të parlamentit u ulën përfaqësuesit e aristokracisë dhe të klasës klerike kurse në anën e majtë u ulën përfaqësuesit e borgjezisë, ata të cilët përgatitën bazat e këtij revolucioni.

Mirëpo më vonë me kalimin e kohës klasa borgjeze ishte ajo e cila dominonte parlamentin, borgjezët kishin marr nën kontroll mekanizmat ekonomik, juridik dhe politik të shtetit. Futja e lëvizjeve të reja në parlament bëri që duke mbrojtur barazinë të luftojë kundër borgjezisë. Borgjezia tanimë duhej që të mbrohej kundër këtyre lëvizjeve që kërkonin barazi. Ky qëndrim u bë shkak për hapjen e konfliktit me parlamentarët e rinj, ashtu që ata (socialistët) të cilët mbronin idenë për barazi me borgjezinë u quajtën “majtistë”, ndërsa ata të cilët ishin kundër kësaj filozofie u quajtën “djathtistë”. (Bulaç, 2005:189-199).

Sociologu britanik Anthony Giddens konstaton se “e djathta” karakterizohet me aristokracinë dhe konservatorizmin, ndërsa “e majta” përdoret për grupet radikale progresiste që priren drejt socializmit. (Giddens, 2002:303).

Partitë e “të djathtës” në përgjithësi përkrahin rendin aktual shoqëror, mbështetësit e tyre rëndom përfshijnë interesat e biznesit dhe klasat e mesme materialisht të kënaqur. Kurse partitë të cilët proklamohen të “së majtës” janë për reformat shoqërore, ose ndryshimit të plotë ekonomik. Këto kanë marrë mbështetjen nga shtresat e varfra, klasat punëtore etj, zakonisht pjesë e së majtës kanë qenë partitë progresive socialiste e komuniste. (Heywood, 2008:233).

Mund të thuhet se botëkuptimi tradicional i dikotomisë “e djathtë - e majtë” është i bazuar në çështjet socio-ekonomike, ose thënë më mirë, kryesisht në rolin e shtetit kur është në pyetje funksionimi i tregut të lirë. Krahu “i majtë” mbron intervenimin shtetëror në tregun e lirë si dhe i mbështet të paaftët për punë, kurse krahu “i djathtë” mbështet tregun e lirë dhe një vetë-mjaftueshmëri individuale - *individual self-sufficiency*- për çështje ekonomike. (Pettitt, 2014; 62- 63).

Mirëpo pas luftës së dytë botërore me që bota përjetoi transformime të ndryshme shoqërore qoftë në aspektin politik, ekonomik e kulturor, këto transformime u ndien edhe tek partitë politike si organizatë. Kështu që prirjet e përgjithshme të shoqërisë politike kanë shkuar në drejtim të dobësimit të ideologjive dhe ndarjeve tradicionale.

Madje studiuesi gjermano-hebre i shkollës së Frankfurtit, Otto Kirchheimer aty kah vitet e 60-ta, partive politike iu dha një emër të ri, përkatësisht “*catch all party*” apo parti “gjithëpërfshirëse”. Ai si faktor për zhvillimin e *catch-all* partive përmend trendet e rritjes së shekullarizmit dhe materializmit. (Williams,2006:22).

Sipas tij, ky model i partive karakterizohet me “de-ideologjizimin” e tyre, ose reduktimin e bagazhit ideologjik të partisë, po ashtu tek këto parti më shumë rëndësi i kushtohet imazhit të partisë sesa programit politik që ofron partia. Kirchemeri pohon se parti të tilla i vënë theks “marketingut” madje sikur të jenë ndonjë *brend* produkti, po ashtu roli i anëtarit individual të partisë është i ulët në krahasim me ata të cilët gjinden në majën e lidërshpit partiak. (Mair, 2014:340).

Nocioni i ndarjes “të djathtë” dhe “të majtë” tek partitë politike për të mos thënë është zhduk, në masë të madhe ka rënë. Kjo ngase partitë politike sot bëjnë politika të atilla që ndasitë në fjalë thuhet aspak nuk vërehen. Kampanjat apo gara zgjedhore ka efektin e



shprishjes së identiteteve ideologjike, ndërsa parimet e dikurshme “të djathtë” ose “të majtë” nuk kanë ndonjë rëndësi.

Problematikat e reja me të cilët ballafaqohet shoqëria, qoftë në aspektin e punësimit, mjedisit jetësor, shëndetësisë, arsimit apo infrastrukturës, bëjnë që ideologjia partiake të duket e tepër. Mund të thuhet se një gjë e tillë e mos vërejtjes së ndarjeve ideologjike vlen edhe për partitë politike në Republikën e Maqedonisë, përfshirë këtu edhe partitë e kampit politik shqiptar.

Partitë politike shqiptare në Maqedoni pa marrë parasysh proklamimit “të djathtë” ose të “majtë”, kur vjen në shprehje marrja e votave, identitetit ideologjik të partisë nuk i kushtohet vëmendje, kjo po ashtu vlen edhe për votuesit e thjeshtë.

### **Identiteti ideologjik tek partitë e kampit politik shqiptar në RM**

Pa dyshim se mënyra e funksionimit, parimet, objektivat, dhe orientimi ideologjik i një partie politike saktësohet me anë të statutit. Nëse kushtetuta përbën aktin më të lartë juridik të një shteti, organizimi juridik i një partie politike bëhet përmes statutit të saj.

Rolin që ka kushtetuta në shtet, po atë rol e luan statuti në parti, me një fjalë partia funksionon nën ombrellën e statutit. Në të shumtën e rasteve emri i një partie politike përcakton atë, se si ajo parti do të perceptohet nga elektorati i gjerë.

Kur bëhet fjalë për partitë politike shqiptare të RM-së mund të thuhet se në bazë të statuteve nuk vërehet ndonjë dallim drastik ndërmjet tyre. Nëse një parti politike për nga profili ideologjik i saj prezantohet para opinionit si parti “e djathtë” ajo promovon edhe politika “të së majtës”, ose e kundërta. P.sh. në kampin politik shqiptar ndodhë që një parti të identifikohet si parti e “së djathtës”, ndërsa në statutin e saj thuhet se ajo mbron edhe të drejtat e punëtorëve. Po ashtu, ndodh që një parti në opinion të njihet si parti e “së majtës” ndërsa statuti i saj përcakton se ajo parti angazhohet për ekonominë e tregut dhe konkurrencës.

Ajo që bie në sy tek partitë politike shqiptare është se tek pjesa më e madhe e partive, në statutet e tyre përmendet çështja e integritimit në strukturat euroatlantike. Tek statutet e të gjitha partive politike thuhet se janë të hapur për të gjithë qytetarët e vendit. Një pjesë bukur e madhe e partive politike shqiptare në statutet e tyre kanë të përfshirë çështjet e politikave arsimore, shëndetësisë, barazitë gjinore etj.

Thënë shkurt tek partitë politike shqiptare në RM, çështja e ndasive ideologjike nuk luan ndonjë rëndësi të madhe, madje as për anëtarët e partisë. Nuk është e tepërt të thuhet se një gjë e tillë nuk i intereson as elektoratit apo trupit votues. Problematikat nga më të ndryshmet me të cilët ballafaqohen qytetarët, nuk ua lejojnë partive politike të bëjnë ndarje të tilla.

Vlen të thuhet po ashtu se partitë politike shqiptare në RM në përgjithësi i karakterizojnë de-ideologjizimi i tyre, si dhe kushtimi rëndësi i “marketingut”. Nëse ndonjë emër duhet të kenë partitë shqiptare më adekuat do ishte emërtimi i Kircheimer-it, pra atë të “*Catch-all party*” ose partive “gjithëpërfshirëse”.

### **Hulumtimi nga terreni**

Pjesë e këtij punimi është edhe analiza e intervistave si mjet i empirik, intervista këto të përbëra nga 3 pyetje. Në intervistë janë përfshirë gjithsejtë 20 persona dhe atë prej moshës 18 vjeçare e gjerë në moshën 45 vjeçare kryesisht nga qyteti i Shkupit, Tetovës dhe Kumanovës. Periudha e realizuar e kësaj interviste ka qenë, pjesa e parë e muajit dhjetor (2015).

Intervistuesit në përgjithësi partitë politike i shohin si organizata apo grupe që duhet të përfaqësojnë popullin, por ka edhe nga ata të cilët këto organizime i shohin më ndryshe p.sh.: “Partia nënkupton një grup njerëzish të cilët punojnë për qëllimet e veta dhe jo të popullit.” (intervista nr. 9).

Prej intervistuesve ka të atillë që pohojnë se “në parti duhet të jenë njerëzit e ndërtuar intelektualisht në çdo prej fushave shoqërore”. (interv. nr. 15), dhe se “partitë duhet të artikulojnë zërin e popullit ose qytetarit”. (interv. nr. 2 dhe 11). Intervistuesi 18-të partitë politike i sheh si aktivitet të përbashkët njerëzor, sipas tij: “Partia politike është organizatë tek e cila bëhen bashkë njerëz të ndryshëm për të arritur qëllimin e përbashkët”.

Sa i përket ndasive “të djathtë” ose “të majtë” për këto koncepte kryesisht njohuri kanë studentët ose të diplomuarit: “e majtë është liberale progresiste, kurse e djathtë konservatore apo regresiste”. (interv. nr.3). Mirëpo ka nga ata të cilët një ndarje të tillë e sheh si të panevojshme: “Një ndarje, në kohën e globalizimit në të cilën edhe jetojmë është pothuaj se inekzistente”. (interv. nr.6).

Identitetet ideologjike të partive shqiptare thuajse nuk vërehen aspak tek personat e intervistuar, madje sipas tyre, as që iu kushtohet

rëndësi ndasive të tilla pra, tek intervistuesit partitë shqiptare në Maqedoni duken të njëjta.

“Në qoftë se flasim për ndonjë dallim thelbësor konceptual, them se dallime për fat të keq nuk ka”. (interv. nr.4), “nuk shoh ndonjë dallim mes tyre të paktën kur janë në pushtet të gjitha veprojnë ngjashëm”. (interv. nr.7), “Sa i përket çështjes së partive shqiptare, më duhet them se ata nuk dallojnë nga njëra tjetra. Premtimi i tyre i vetëm është integrim në NATO dhe BE”. (interv. nr. 11).

Në bazë të intervistës shihet se partitë politike shqiptare në syrin e intervistuesve nuk kanë ndonjë dallim thelbësor. Pa marrë parasysh proklamimit të tyre nëpër fushata ose nëpër media, tek qytetarët duket se ata të gjitha paraqesin thujtë të njëjtën platformë.

### **Conclusion**

The issue of research or study of political parties was an object of interest of those who study political science, this is because political parties can be found everywhere.

Political parties still remain organizations through which people group in order to take and practice power in a legal way. We can't talk about a democratic state or society with full sense of the word, if there are no political parties.

Through them, people display the program and platform with the purpose of directing their power, so that later, that platform translates into everyday life, i.e. to make it a reality. Their institutionalization enables the electoral race between different subjects. This race in no way should turn into a hostile rivalry, but in this political electoral race should be seen the value of democracy.

In our circumstances, we can say that political ideologies have no importance at all, or better say, we have a de-ideologization of political parties. The battle of political parties, their aim for votes makes that the party ideology be left behind, it's even useless to be talked about.

Even our interviewees can't see such a difference in political parties, simply, according to them, all political parties are the same, in the way of their functioning, and policy-making.

Bearing in mind that the above paper has space for further corrections, the readers' suggestions are fully welcomed.

### **Përfundim**

Çështja e hulumtimit apo studimit të partive politike çdo herë iu ka interesuar studiuesve të shkencave politike, kjo ngase partitë politike i hasim thujse kudo.

Partitë politike edhe më tej ngelin organizata përmes së cilës njerëzit grupohen për të marrë dhe ushtruar pushtetin në mënyrë legale. Nuk mundet të flitet për një shtet ose shoqëri demokratike me kuptim të plotë të fjalës, nëse nuk ka parti politike.

Përmes tyre njerëzit shpalosin programin dhe platformën me qëllim që të drejtojnë pushtetin, që më pas po atë platformë të tyre ta përkthejnë në jetën e përditshme, pra ta bëjnë realitet. Institucionalizimi i tyre bën të mundur garën para zgjedhore mes subjekteve të ndryshme. Kjo garë në asnjë mënyrë nuk duhet kalon në rivalitet armiqësor por kjo gara politike parazgjedhore duhet të shihet vlerë e demokracisë.

Në nënqiellin tonë mund të thuhet se ideologjitë politike nuk kanë asnjë rëndësi, ose thënë më mirë kemi de-ideologjizim të partive politike. Beteja e partive politike synimi i votave bën që ideologjia partiake të lihet pas shpine madje është e tepërt të bisedohet.

Madje edhe të intervistuarit tonë një dallim të tillë nuk e vërejnë tek partitë politike, thjesht sipas tyre gjitha partitë janë të njëjta, për nga mënyra e funksionimit dhe e bërjes së politikave.

Duke pasur parasysh atë se punim i mësipërm posedon hapësirë për korrigjim të mëtutjeshëm, sugjerimet e lexuesit janë plotësisht të mirëseardhura.

### **Referenca**

AZIRI, Etem. (2004). "Sociologjia e partive politike", Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.

BULLAÇ, Ali. (2005). "Koncepte dhe sisteme bashkëkohore", Shkupë, Logos-A.

DIAMOND, Larry. GUNTHER, Richard. (2001). "Political Parties and Democracy", Maryland: Johns Hopkins University.

DALTON, J. Russel. FARELL, M. David. McALLISTER, Ian. (2011). "Political Parties and Democratic Linkage: How Parties Organize Democracy", Oxford: University of Oxford.

DENQUIN, Marie -Jean. (2010). "Hyrje në Shkencat politike", Tiranë: UET Press.

GIDDENS, Anthony, (2002). "Sociologjia", Tiranë.

HEYWOOD, Andrew. (2008). "Politika", Prishtinë: Brezi'81

MAIR, Peter. (2014). "On Parties, Party Systems and Democracy", Colchester, United Kingdom: ECPR Press.

PAJAZITI, Ali, (2009). "Fjalor i Sociologjisë", Shkup: Universitetit i Evropës Juglindore UEJL & Logos-A.

PETTITT, T. Robin. (2014). "Contemporary Party Politics", United Kingdom: Palgrave Macmillan.

SEILER, Louis – Daniel. (Pa datë botimi). "Partitë Politike" Tiranë: UET Press.

WILLIAMS, Hale Michelle. (2006). "The Impact of Radical Right-Wing Parties in West European Democracies", United Kingdom: Palgrave Macmillan.

WEBER, Marx. (2014). "Wirtschaft und Gesellschaft: Grundriß der verstehenden Soziologie", E-artnow.

КЛИМОВСКИ, Саво. & КАРАКАМИШЕВА, Тања. (2006). "Политички партии и интересни Групи", Скопје: 2-Август.

### **Statutet e partive politike:**

- STATUTI i Partisë për Prosperitet Demokratik.
- STATUTI i Partise Demokratike Shqiptare – Maqedoni.
- STATUTI i Bashkimit Demokratik për Integrim.
- STATUT I Lëvizjes BESA.
- STATUTI i Lëvizja për Reforma-PDSH
- STATUTI i Rilindjes Demokratike Kombëtare.